

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6263
E shtunë, 13 mars 2021
çmimi 0.40 €

Palmeri: Opozita duhet të qëndrojë në sallë kur të votohet presidenti FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SOT (E SHTUNË) NJË VJET PREJ QË NË KOSOVË JANË RAPORTUAR RASTET E PARA ME COVID-19

KOSOVA ENDE PA ASNJË VAKSINË KUNDËR VIRUSIT 'KORONA' FAQE 4-5



Është mbushur një vjet prej që Kosova është prekur nga pandemia Covid-19, ndërsa këtu ende nuk ka arritur asnjë dozë e vaksinës kundër virusit "Korona". Derisa vendet e rajonit kanë filluar vaksinimin e

qytetarëve kundër këtij virusi, në Kosovë ende nuk dihet data e saktë se kur mund të arrijë vakcina. Zyrtarët qeveritarë kanë bërë me dije se brenda pak javësh vakcina do të arrijë edhe në Kosovë. Prej paraqitjeve të

rasteve të para pozitive me Covid-19, ndikimi i pandemisë ka qenë i madh në çdo sektor në vendin tonë. Deri më tani numri total i rasteve pozitive është 76 110, ndërkaq si pasojë e këtij virusi kanë vdekur 1 688 persona

OPINION

PRANVERA E VETMISË SË MADHE TË UÇK-së F. 11

Shkruan:
Ismail SYLA



VITI 1981, SIDOMOS PRANVERA E TIJ, KA QENË VITI I PROVËS PËR SHQIPTARËT E KOSOVËS F. 10

Shkruan:
Bedri ISLAMI



AKTUALE

KURTI KËRKON NGA QEVERIA NË DETYRË T'I NDALË REKRUTIMET DHE NOMINIMET F. 7

ARRESTOHET KRYETARI I KOMUNËS SË KLLOKOTIT PËR CENIM TË VOTËS SË LIRË F. 6

EKONOMI



RRITET KOSTOJA E NDËRTIMIT F. 9

NITAJ KISHTE KËRKUAR I PARI ANULIMIN E ZGJEDHJES SË KRYESHEFIT EKZEKUTIV TË "INFRAKOS"-it F. 9

KULTURË

BIBLIOTEKA E QYTETIT NË MITROVICË DO TË FURNIZOHET ME LIBRA DHE LAPTOPË F. 8



PDK-ja DHE AAK-ja I PËRGJIGJEN POZITIVISHT FTESËS SË KURTIT DHE OSMANIT

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) i janë përgjigjur pozitivisht ftesës së Albin Kurtit dhe Vjosa Osmanit për të marrë pjesë në takimin e thirrur më 15 mars, ku do të diskutohet për formimin e institu-

cioneve, pas zgjedhjeve të 14 shkurtit. Ndërkaq Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) nuk ka dhënë përgjigje pozitive se do të mund të marrë pjesë në këtë takim, pasi të dielën do të mbahen zgjedhjet për kryetarin e ri të kësaj partie FAQE 6-7

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shefi i OKB-së: Miliona njerëz kërcënohen nga uria

NJU-JORK, 12 MARS - Dhjetëra miliona njerëz në dhjetëra vende përballen me uri akute, kryesisht për shkak të konflikteve, tha sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres. "Pa veprime të menjëhershme, miliona njerëz do të arrijnë në prag të urisë ekstreme dhe vdekjes", ka thënë ai në një takim të nivelit të lartë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Guterres ka theksuar se mbi 30 milionë njerëz në dhjetëra vende janë "vetëm një hap larg" urisë. Derisa konfliktet nxisin pjesën më të madhe të urisë, "tronditjet klimatike dhe pandemia Covid-19 po u shtojnë karburant flakëve", ka pohuar Guterres. Saheli, Sudani i Jugut, Jemeni dhe Afganistani janë ndër vendet dhe rajonet më të prekura. Guterres bëri thirrje për

grumbullimin e 5.5 miliardë dollarëve fonde për të shmangur katastrofën. Drejtori ekzekutiv i Programit Botëror të Ushqimit, David Beasley, ka deklaruar se pandemia Covid-19 dhe një pandemi urie mund ta rrisin numrin e njerëzve që "marshojnë drejt urisë" nga 135 milionë në 270 milionë. Ai e përshkroi kërcënimin si "zi buke me përmasa biblike".



Navalny transferohet në një lokacion të panjohur

MOSKË, 12 MARS - Avokatët e politikanit opozitar rus, Aleksei Navalny, kanë thënë se ai është bartur nga një qendër ndalimi në rajonin Vladimir, në një lokacion të panjohur, ndërkohë që rriten thirrjet nga Perëndimi për lirim të tij të menjëhershëm. Navalny, kritik i presidentit rus Vladimir Putin, është dërguar në burg muajin e kaluar për të kryer dy vjet e gjysmë të dënimit të lidhur me një rast të përvetësimit. Ai dhe aktivistët për të drejtat e njeriut kanë thënë vazhdimisht se rasti i tij është i motivuar politikisht. Autoritetet, në anën tjetër, kundërshtojnë një gjë të tillë. Më 3 mars Navalny ka thënë se është bartur nga qendra e ndalimit numër 3 në qytetin Kolchugino, ndonëse është pritur që ai të dërgohet në një koloni penale afër qytetit



Pokrov, 100 kilometra në lindje të Moskës. Kjo koloni konsiderohet si një nga më të ashprat në pjesën evropiane të Federatës Ruse.

Pas lajmit për transferimin e tij, dhjetëra shtete, përfshirë Shtetet e Bashkuara, kanë bërë thirrje për lirim të tij të menjëhershëm dhe për hetime

lidhur me helmimin që i është bërë Navalnyt vitin e kaluar me agjent nervor. Navalny është ndaluar në aeroportin e Moskës në janar,

pasi ka arritur nga Berlina, për t'u trajtuar pas helmimit. Disa laboratorë perëndimorë kanë vërtetuar se ai është helmuar me agjent nervor Novičok në gusht të vitit 2020. Rusia ka mohuar përfshirjen, mirëpo Navalny ka thënë se tentimi për vrasjen e tij është urdhëruar nga presidenti rus Vladimir Putin. Një gjykatë në Moskë ka marrë vendim në shkurt se në kohën sa ka qenë Navalny në Gjermani, ai ka shkelur kushtet e një dënimi të lidhur me përvetësim. Dënimi i tij me kusht është shndërruar në dënim me burgim, ndonëse gjyqi i ka zvogëluar kohën e burgut në dy vjet e gjysmë. Ndalimi i tij ka nxitur një varg protestash kombëtare dhe shtypje të mbështetësve të tij.

Tajlanda pezullon përdorimin e vaksinës "AstraZeneca"

BANKOK, 12 MARS - Tajlanda e shtyu shpërndarjen e vaksinës "AstraZeneca" kundër koronavirusit për shkak të raporteve se shkakton mpiksje të gjakut - ndonëse nuk ka prova për këtë. Kryeministri i këtij vendi, Prayut Chan-o-cha, planifikoi të nisë përdorimin e kësaj vaccine sot, por kjo u anulua. "Edhe pse cilësia e

'AstraZenecas' është e mirë, disa vende kanë kërkuar shtyrjen", ka thënë një këshilltar i Qeverisë tajlandeze. Disa vende në Evropë, përfshirë Danimarkën dhe Norvegjinë, e pezulluan përdorimin e "AstraZeneca"-s. Rreth 5 milionë evropianë, në anën tjetër, e kanë marrë atë. Nga kjo shifër, rreth 30 raste kanë raportuar mpiksje të

gjakut. Agjencia Evropiane e Barnave ka thënë këtë javë se nuk ka indikacione që tregojnë se vaksina shkakton mpiksje të gjakut. Sipas kësaj agjencie, "përfitimet nga vaksina vazhdojnë t'i tejkalojnë rreziqet e saj". "AstraZeneca" ka thënë se siguria e ilaçit është studiuar gjerësisht gjatë provave klinike.



Meta përplasat me policinë: Do t'ju çoj në burg me duart e mia

TIRANË, 12 MARS - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, është përplasur të premtën me policinë bashkiake në zyrat e FRD-së, ku ai ishte për vizitë,

madje duke i kërcënuar policët se do t'i fusë në burg. "Dilni përjashta, mos krijoni probleme. Kaq po ju them. Do t'ju çoj në burg me duart e mia",

u ka thënë presidenti Ilir Meta punonjësve të policisë tejet i acaruar. Shkak është bërë një konflikt që nisi pasi anëtarët e FRD-së nuk pranorin t'i lironin

zyrat me kërkesë të bashkisë së Tiranës, ku në një shkresë të kësaj të fundit thuhet se ata duhet të dalin pasi ndërtesa është e amortizuar.



PDK-ja dhe AAK-ja i përgjigjen pozitivisht ftesës së Kurtit dhe Osmanit

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) i janë përgjigjur pozitivisht ftesës së Albin Kurtit dhe Vjosa Osmanit për të marrë pjesë në takimin e thirrur më 15 mars, ku do të diskutohet për formimin e institucioneve, pas zgjedhjeve të 14 shkurtit. Ndërkaq Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) nuk ka dhënë përgjigje pozitive se do të mund të marrë pjesë në këtë takim, pasi të dielën do të mbahen zgjedhjet për kryetarin e ri të kësaj partie

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 MARS - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe kandidatja për presidente, Vjosa Osmani, përmes një letre të përbashkët i kanë ftuar në takim, më 15 mars, Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) për të diskutuar për krijimin e institucioneve të reja.

Në letrën e liderit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, dhe kandidatës për presidente, Vjosa Osmani, drejtuar liderëve të partive të tjera, theksohet se takimet do të mbahen në formatin 1+1, me takimet që planifikohen të nisnin në orën 11:00 të 15 marsit, me kreun e PDK-së, Enver Hoxhaj. Partia Demokratike e Kosovës

(PDK) u është përgjigjur pozitivisht ftesës së Albin Kurtit dhe Vjosa Osmanit për të marrë pjesë në takimin ku do të diskutohet për formimin e institucioneve, pas zgjedhjeve të 14 shkurtit. Lajmin e ka bërë me dije nënkryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, duke shtuar se qëndrimet e kësaj partie do t'i bëjnë të njohura në këtë takim. "PDK-ja do të marrë pjesë në takimin e ftuar të hënën. Si parti kryesore opozitare, qëndrimet tona rreth formimit të institucioneve do t'i bëjmë të njohura në takim", ka thënë Krasniqi.

Edhe lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, do të marrë pjesë në takimin e ftuar nga Albin Kurti dhe Vjosa Osmani, i cili pritet të mbahet të hënën, ku do të diskutohet rreth formimit të institucioneve. "Pas

konsultimeve në kryesi, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës konfirmon praninë e kryetarit z. Ramush Haradinaj në takimin e thirrur nga kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, z. Albin Kurti, për të hënën në orën 13:30 në Kuvendin e Kosovës", ka njoftuar AAK-ja.

Ndërkaq kryetari në dorëheqje i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, ka thënë se do të jenë të hapur për biseda dhe dialog për konstituimin e institucioneve të reja. Përkundër

këtij vullneti, Mustafa ka deklaruar se nuk mund të flasë për gatishmërinë e kryetarit të ri, pas Kuvendit Zgjedhor të së dielës, që menjëherë të hënën të takohet me Albin Kurtin dhe Vjosa Osmanin. Duke iu përgjigjur ftesës së Kurtit dhe Osmanit, Mustafa nuk sheh asgjë të keqe nga bisedat për përgatitjen e konstituimit të Kuvendit. Sipas tij, LDK-ja nuk është parti e barrikadave, duke shtuar se nuk janë si të tjerët që kanë gjuajtur me gaz dhe molotov

kur është dashur të bisedohet. "LDK-ja gjithëherë ka qenë e hapur për biseda dhe dialog. Nuk jemi barrikaduar si të tjerët dhe nuk i kemi gjuajtur të tjerët me gaz e me molotov kur është dashur të bisedojmë. Kuvendi është i të gjithëve, jo vetëm i atyre që janë renditur të parët. Nuk shoh asgjë të keqe nga bisedat për përgatitjen e konstituimit të Kuvendit, por se kur LDK-ja do të jetë e gatshme të marrë pjesë, nuk mund të flas", ka deklaruar Mustafa për "KosovaPress".

Palmeri: Opozita duhet të qëndrojë në sallë kur të votohet presidenti



PRISHTINË, 12 MARS - Zëvendësndihmëssekretari amerikan i shtetit, si dhe përfaqësuesi special i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer, në një intervistë për "RTV Dukagjini" ka thënë se ShBA-ja do të punojë me çdo qeveri që del nga zgjedhjet e lira dhe

demokratike. Palmeri ka theksuar se do të donte të shihnte një qeveri të fortë, e cila do të jetë një partnere e mirë e ShBA-së. "Do të dëshironim të shohim qeveri të formuar, qeveri që do të jetë partnere e mirë, e fortë për Shtetet e Bashkuara. Nuk kemi të parapëlqyer në politikën e

të tjerëve; punojmë me qeveritë që dalin nga zgjedhjet e lira, të drejta dhe demokratike. Duket që ka rrugë shumë të qartë përpara drejt një qeverie të fortë në Kosovë, që mund të jetë partnere e tillë e Shteteve të Bashkuara", ka deklaruar ai.

Palmeri ka shtuar se opozita

duhet të jetë lojale ndaj qytetarëve dhe të qëndrojë në Kuvend kur të zgjedhet presidenti. "Sa iu përket zgjedhjeve për presidencë, ne mendojmë se ato parti që do të jenë në opozitë, të veprojnë me përgjegjësi si opozitë lojale, lojale jo ndaj qeverisë, por ndaj shtetit. Ta bëjnë punën e tyre, të jenë të

pranishme, të sigurojnë që ka kuorum për të votuar dhe që institucionet të mund të funksionojnë. Gjërat e fundit që i duhen Kosovës janë zgjedhjet e tjera. Kosovës i duhet një qeveri, një president dhe rrugëtim përpara drejt Evropës", ka deklaruar Palmer.



SOT (E SHTUNË) NJË VJET PREJ QË NË KOSOVË JANË RAPORTUAR RASTET E PARA ME COVID-19

Kosova ende pa asnjë vaksinë kundër virusit 'Korona'

Është mbushur një vjet prej që Kosova është prekur nga pandemia Covid-19, ndërsa ende nuk ka arritur asnjë dozë e vaksinës kundër Covidit. Derisa vendet e rajonit kanë filluar vaksinimin e qytetarëve kundër këtij virusi, në Kosovë ende nuk dihet data e saktë se kur mund të arrijë vakcina. Zyrtarët qeveritarë kanë bërë me dije se brenda pak javësh vakcina do të arrijë edhe në Kosovë. Prej paraqitjeve të rasteve të para pozitive me Covid-19, ndikimi i pandemisë ka qenë evident në çdo sektor në vendin tonë. Deri më tani numri total i rasteve pozitive është 76 110, ndërkaq si pasojë e këtij virusi kanë vdekur 1 688 persona

beson që masat që i kanë dizajnuar bashkë në këtë komitet e kanë mundësuar funksionimin dhe mosmbylljen e plotë të ekonomisë, mbajtjen gjallë të aktivitetit ekonomik, në mënyrë që familjet dhe bizneset të tejkalojnë këtë situatë. "Besoj se ka qenë përvojë jetësore për të gjithë neve përballja me këtë pandemi që ndodh një herë në 100 vjet. Kemi kaluar një vit vërtet të jashtëzakonshëm dhe e them me kënaqësi që ia kemi dalë në masë të madhe,

megjithëse kemi pasur resurse të kufizuara në këtë drejtim. Unë dëshiroj të falënderoj stafin shëndetësor për mobilizimin e jashtëzakonshëm që ka bërë gjatë kësaj periudhe, pa pushim, 24 orë, pa asnjë ditë pushim duke u përballur çdo ditë me rrezikun e infektimit të tyre", ka thënë Hoti.

Ai ka treguar për mobilizimin që ka bërë qeveria e tij për t'u përballur me këtë pandemi. "I kemi rritur kapacitetet testuese dhe sot e them me kënaqësi që

testohen mbi 3 000 veta brenda ditës. Praktikisht, çdo kush që ka nevojë të testohet nuk mbetet pa u testuar, pavarësisht kostos së madhe që ka kjo për institucionet. Janë riorganizuar spitalet tona, është ngritur furnizimi me oksigjen dhe është përmbyllur praktikisht furnizimi me oksigjen sipas standardeve" është shprehur ai, duke treguar edhe për masat që ka marrë qeveria për t'u dalë në ndihmë qytetarëve dhe bizneseve. "Qindra mijëra



**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

Prishtinë, 12 mars - Sot (e shtunë) bëhet një vjet që edhe Kosova është prekur nga pandemia Covid-19. Pas paraqitjeve të rasteve të para më 13 mars të vitit 2020, qeveria e atëhershme kishte marrë masa për ta izoluar vendin për dy muaj. Përgjatë këtij viti Kosova është përballur me shumë sfida në aspektin shëndetësor dhe ekonomik. Si në çdo vend të botës, edhe në Kosovë pasojat e pandemisë janë evidente. Deri më tani nga Covid-19 kanë humbur jetën 1 688 persona

dhe janë infektuar 76 110 persona, ndërsa në aspektin ekonomik shumë biznese janë mbyllur dhe mijëra punëtorë kanë humbur vendet e tyre të punës. Megjithatë, institucionet e Kosovës pretendojnë se Kosova bën pjesë te vendet që kanë menaxhuar më së miri pandeminë Covid-19. Të premtën kryeministri në detyrë ka mbledhur komitetin për koordinimin dhe vlerësimin e situatës epidemiologjike lidhur me Covid-19, ku ka lavdëruar masat që ka marrë qeveria e tij për parandalimin e përhapjes së pandemisë. Me këtë rast, Hoti ka deklaruar se

qytetarë dhe biznese kanë ndier dorën e shtetit gjatë kësaj periudhe dhe praktikisht ne tash me të dhënat që kemi qëndrojmë shumë më mirë se në muajt e parë të vitit 2020 dhe gradualisht po kthehemi në normalitetin e funksionimit të ekonomisë”, ka thënë ai.

Drejtori i Klinikës Emergjente në QKUK, Basri Lenjani, ka thënë se për momentin situata me Covid-19 në Shërbimin Spitalor Klinik e Universitar të Kosovës është e menaxhueshme. Lenjani ka theksuar se në nivel vendi janë të shtrirë 632 të sëmurë me Covid. “Prej tyre 290 janë të shtrirë në QKUK, 402 në spitale regjionale. Në nivel vendi 487 janë me oksigjenoterapi, 23 janë me mbështetje të avancuar të rrugës së frymëmarrjes, ndërkaq pesë janë të intubuar. Në QKUK dhe në spitale

vlerësimeve të organizatave ndërkombëtare lidhur me këtë pandemi. Për disa javë ne presim arrijen e vaksinave dhe do ta fillojmë vaksinimin masiv bazuar në strategjinë e imunizimit që tashmë është përgatitur. Të gjitha përgatitjet janë bërë në këtë drejtim”, ka deklaruar Hoti, duke shtuar se Ministria e Shëndetësisë dhe IKShPK-ja i kanë bërë të gjitha përgatitjet teknike për të filluar vaksinimi. “Më lejoni të them edhe një herë, edhe për vaksinën jemi kritikuar, por ne kemi bërë të gjitha përgatitjet për ta sjellë vaksinën sipas standardeve të BE-së. Nuk kemi hyrë në lojëra për ta sjellë vaksinën nga vendet e lindjes, të cilat vakcina nuk janë të certifikuara nga vendet e Bashkimit Evropian”, ka thënë Hoti.



nuk ka siguruar asnjë vaksinë anti-Covid. Ndryshe nga shtetet e tjera, Kosova ende nuk ka arritur ta sigurojë vaksinën anti-Covid për qytetarët e saj. Ky dështim total për menaxhimin e pandemisë është përgjegjësi e të dyja qeverive, Kurtit dhe Hotit”, ka vlerësuar deputeti i zgjedhur i PDK-së, Bekim Haxhiu. Sipas tij, menaxhimi pandemisë është bërë në mënyrë katastrofale. “Numri i rasteve po rritet çdo ditë. Tanimë nuk dihet as në cilën valë të pandemisë jemi, e as cili variant i virusit po shpërndahet, ndërsa për menaxhim të kufijve, se kush mund të na sjellë variantin e ri të virusit, as që mund të diskutohet! Ajo që kemi parë deri tani është pabarazia dhe diskriminimi në mbështetjen financiare të profesionistëve shëndetësorë dhe stafit mbështetës”, ka shkruar Haxhiu në profilin e vet në “Facebook”. Edhe Lëvizja Vetëvendosje vazhdimisht e ka kritikuar qeverinë Hoti për mosmenaxhim të mirë të pandemisë Covid-19. Dy rastet e para të infektimit me Covid në Kosovë janë paraqitur më 13 mars të vitit 2020. Një nga të

konfirmuarit pozitiv në Covid-19 ishte një shtetase italiane e moshës 20-vjeçare, kurse pacienti i dytë ishte qytetar i Kosovës i moshës 77-vjeçare. Pas regjistrimit të këtyre rasteve, IKShPK-ja me institucionet e tjera kanë filluar menjëherë gjurmimin e të gjitha kontakteve të dy pacientëve dhe janë marrë të gjitha masat e izolimit dhe vetëkarantinimit të personave me të cilët kanë qenë në kontakt të konfirmuarit

pozitiv me Covid-19. Një vjet më parë, më 11 mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë e ka shpallur shpërthimin e sëmundjes Covid-19 pandemi globale. Rastet e para janë identifikuar në Vuhan të Kinës në dhjetor të vitit 2019. Që atëherë, virusi është përhapur në çdo cep të globit, duke marrë mbi 2.6 milionë jetë njerëzish dhe duke shkaktuar rënie të mëdha ekonomike.



regjionale 90 për qind e shtretërve janë në shfrytëzim”, ka pohuar Lenjani në takimin e komitetit për vlerësimin e situatës me Covid-19.

Vaksina brenda javësh

Para komitetit, kryeministri në detyrë Avdullah Hoti ka folur edhe për vaksinën kundër Covidit. Ai ka bërë me dije se brenda pak javësh edhe në Kosovë do të arrijë vakcina. “Tash jemi në fazën finale të kësaj pandemie në bazë edhe të

Opozita kritikon qeverinë për menaxhimin e pandemisë

Gjatë gjithë vitit qeveria vazhdimisht është kritikuar nga opozita për menaxhim jo të mirë të pandemisë Covid-19. Fillimisht, qeveria është kritikuar për mungesë të maskave, pastaj për mungesë të testeve dhe, së fundi, për çështjen e vaksinës. “Një vjet që kur Covid-19 u shpall pandemi dhe Ministria e Shëndetësisë

Në 24 orët e fundit edhe gjashtë viktima dhe 730 të infektuar me Covid

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK) ka treguar se në 24 orët e fundit janë regjistruar gjashtë viktima me Covid-19. “Rastet e vdekjes janë nga komunat: Gjilan 1 rast (76 vjeç), Prishtinë 2 raste (80, 87 vjeç), Gjakovë 1 rast (79 vjeç), Viti 2 raste (74, 16 vjeç)”, është thënë në njoftimin për media. Sipas IKShPK-së, gjatë kësaj

periudhe kohore janë identifikuar 730 raste të infektimit me këtë virus, pas testimit të 3 317 mostrave në institucionet publike dhe ato private. Pavarësisht prej rritjes së numrit të të infektuarve me Covid, kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë të enjten se do të vazhdojnë të zbatohen masat e njëjta për luftimin e kësaj pandemie.



Hoxhaj: PDK-ja do të bëjë reformë të brendshme e të thellë

Prizren, 12 mars (ER) - Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka vazhduar vizitat në degët e kësaj partie në Prizren, Rahovec dhe Dragash. "Kam takuar kryesitë e këtyre

degëve, me të cilat kam diskutuar për punën që e pret partinë pas përfundimit të zgjedhjeve nacionale, si dhe i kam falënderuar për përkushtimin dhe angazhimin e deritanishëm. Partia Demokratike e

Kosovës do të bëjë një reformë të thellë të brendshme dhe nga pozicioni i opozitës do të vazhdojë të angazhohet për të mirën e qytetarëve dhe vendit", ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Arrestohet kryetari i Komunës së Kllokotit për cenim të votës së lirë



KLLOKOT, 12 MARS (ER) - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka njoftuar se është arrestuar kryetari i Komunës së Kllokotit, Bozhidar Dejanović, i dyshuar për "cenimin e përcaktimit të lirë të votuesve". Në njoftim bëhet me dije se Dejanović është ndaluar për 48 orë dhe brenda afati ligjor do të paraqitet para gjyqtarit të procedurës paraprake. "Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, njofton opinionin publik se sot ka ekzekutuar urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake, për kontrollimin e objekteve të Komunës së

Kllokotit, në lidhje me një hetim që është duke zhvilluar ndaj kryetarit të komunës, të pandehurit Bozhidar Dejanović, nën dyshimin se ka kryer veprën penale 'cenim i përcaktimit të lirë të votuesve', e paraparë dhe sanksionuar me nenin 210 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje 'KPRK'). Mbi këtë bazë, me vendim të prokurorit të çështjes u vendos ndalimi dhe arrestimi i të pandehurit Bozhidar Dejanović për 48 orë dhe brenda afati ligjor do të paraqitet para Gjyqtarit të procedurës Paraprake", thuhet në njoftimin për media.

Jasharaj, qeverisë së re: Plotësoji kërkesat tona, përndryshe greva është e pashmangshme

PRISHTINË, 12 MARS - Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, në një intervistë për "Ekonomia Online", ka thënë se qeveria e re duhet të përgatitet për dy opsione: ose t'i plotësojë kërkesat e tyre ose greva është e pashmangshme. Ai ka potencuar se ky nuk është kërcënim, por që nëse ekzekutivi heziton të marrë për bazë kërkesat e tyre, atëherë s'do të kenë konsideratë. "Letër zyrtare nuk kemi dërguar. Ne kemi

dashur që të presim, në mënyrë që të krijohen institucionet e reja. Kemi thënë publikisht që edhe qeveria Kurti duhet të përgatitet për dy opsione: ose ta zgjedhë opsionin e dialogut me ne, sepse kur mungon dialogu, pastaj e respektojmë vullnetin e anëtarësisë dhe pavarësisht se kush e udhëheq Kosovën, ne grevat nuk i përjashtojmë. Pra, nëse dialogu nuk funksionon, mënyra e vetme e lejuar me ligj është greva", ka thënë Jasharaj.



Ambasadori i Zvicrës takon Osmanin, flasin për formimin sa më të shpejtë të institucioneve



PRISHTINË, 12 MARS (ER) - Ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të premtën në takim ambasadorin e Zvicrës në Republikën e Kosovës, Thomas Kolly. Me këtë rast, Osmani e ka falënderuar ambasadorin Kolly për pritjen e institucioneve zvicerane në vizitën zyrtare, si dhe ka shprehur mirënjohje të thellë për takimet konstruktive dhe

përmbajtjesore me përfaqësuesit më të lartë institucionalë. "U. d. presidentja Osmani theksoi, po ashtu, që si rezultat i kësaj vizite, tashmë janë ndërmarrë hapat e parë për konkretizimin e bashkëpunimit ndërparlamentar dhe që shumë shpejt do të iniciohen projekte dhe nisma të tjera në fusha të ndryshme konform prioritetëve zhvillimore të qeverisjes së re. Në takim u fol

për rëndësinë e themelimit sa më të shpejtë të institucioneve, me ç'rast u theksua nevoja për respektim të plotë të vullnetit të shprehur të qytetarëve", thuhet në njoftimin për media. Duke folur për situatën aktuale me pandeminë, u. d. presidentja Osmani vlerësoi lart gatishmërinë e autoriteteve zvicerane për t'i parë mundësitë për ta ndihmuar Kosovën për sigurimin e vaksinave.

ShSKUK-ja furnizohet me pajisje mjekësore për trajtimin e pacientëve me Covid-19

EPOKA
ERE

FATON DËRMAKU

PRISHTINË, 12 MARS - Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka pranuar pjesën e dytë të pajisjeve mjekësore, aparaturë e dorës së fundit, shumë e nevojshme për trajtimin e pacientëve të infektuar me Covid-19.

Në pajisje përfshihen: 600 maska helmetë - CPAP, 15 analizatorë të gazrave në gjak, 100 pompa respiratore kirurgjike me rrymë, 200 pajisje me presion të lartë për terapi me oksigjen, me set të pajisjeve përcjellëse. "Këto pajisje do të shpërndahen në QKUK dhe nëpër spitalet e përgjithshme, në përputhje me kërkesat. Ato kanë arritur sot në Qendrën

Klinike Universitare përmes UNOPS dhe janë pjesë e 'Projektit Emergjent Covid-19 për Kosovë', i financuar nga një kredi e Bankës Botërore, i cili, sipas parashikimeve, pritet rrumbullakohet ditët në vazhdim me ardhjen e kontingjentit të fundit me pajisje mjekësore", është bërë me dije në njoftimin e ShSKUK-së.

Drejtori i ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, i shoqëruar nga ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, pasi përmyllën procedurat e pranim-dorëzimit, theksuan peshën e furnizimit me aparaturë të re, në kohën kur në Kosovë ka rritje të ndjeshme të numrit të të prekurve me virusin Covid-19.

Kurti kërkon nga qeveria në detyrë t'i ndalë rekrutimet dhe nominimet

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 MARS - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje dhe kandidati për kryeministër, Albin Kurti, ka kërkuar nga qeveria në detyrë që t'i ndalë rekrutimet, nominimet dhe keqshpenzimet e parasë publike. "Çdo intervistim, nominim, rekrutim apo emërim duhet të ndërpritet menjëherë dhe të mos vazhdojë deri në votimin e qeverisë së re. Secili emërim i nënshkruar pas rrëzimit të qeverisë antikushtetuese do të anulohet që në javën e parë të qeverisjes, dhe kjo vetëm mund t'i dëmtojë personat e përfshirë. Secili vendim që ka nënkuptuar shpenzim të pakontrolluar të parasë publike pas rrëzimit të

qeverisë antikushtetuese do të auditohet dhe për çdo keqpërdorim do të fillohen procedurat normale të kërimit të përgjegjësisë", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se vetëm institucionet e reja që burojnë nga vullneti i zgjedhjeve të 14 shkurtit kanë mandat ta sigurojnë avancimin e institucioneve publike. "E ndiej të domosdoshme të ritheksoj që vetëm institucionet e reja që burojnë nga vullneti i zgjedhjeve të 14 shkurtit kanë mandat ta sigurojnë avancimin e institucioneve publike, përfshirë këtu edhe ndërmarrjet e rëndësishme të veçantë dhe rregullatorët apo agjencitë ekzekutive", ka thënë Kurti.



Gjykata Supreme hedh poshtë shtatë ankesa të tjera kundër vendimeve të PZAP-së



PRISHTINË, 12 MARS (ER) - Gjykata Supreme e Kosovës ka hedhur poshtë të premten pjesën e mbetur të ankesave të dërguara në këtë institucion kundër vendimeve të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës. Një ditë më parë ky trup ka hedhur poshtë nëntë ankesa të tjera të lidhura me kërkesa për rinumërim apo manipulim të votave. Në vendimin e së premtes, gjykata ka hedhur poshtë ankesat e Lëvizjes Vetëvendosje,

Iniciativës Rome, Partisë Liberale Egjiptiane, Partisë së Ashkalive për Integrim, Lëvizjes Përparimtare të Romëve të Kosovës, Iniciativës Qytetare Komuniteti i Bashkuar-Adrijana Hoxhiq dhe Unionit Socialdemokrat (SDU). Adrijana Hoxhiq i është drejtuar Gjykatës Supreme për të kundërshtuar një vendim të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, që ia anuloi mbi 4 200 vota, që i kishte siguruar në komunat e

banuara me shumicë serbe. Hoxhiqi e ka vlerësuar vendimin e PZAP-it, të marrë më 8 mars, "skandaloz dhe të papranueshëm" pasi, sipas saj, me anulimin e votave shkelen të drejtat themelore të qytetarëve të Kosovës. Ajo ka paralajmëruar se nëse Supremja nuk hedh poshtë vendimin e PZAP-it, do të shfrytëzojë edhe instancën të tjerë gjyqësore, duke aluduar në Gjykatën Kushtetuese dhe mekanizmat ndërkombëtarë.

Biblioteka e qytetit në Mitrovicë do të furnizohet me libra dhe laptopë

MITROVICË, 12 MARS (ER) - Nën kryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, i shoqëruar nga drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci, kanë pritur në takim asistentin ekzekutiv të shefit të misionit diplomatik të Ambasadës Suedeze në Kosovë, Armend Rexha, si dhe përfaqësues nga "The Library Project Kosova", me të cilët është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për furnizimin e bibliotekës së qytetit "Latif Berisha" me

libra dhe laptopë. Qëllimi i projektit është të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e leximit dhe ta promovojë letërsinë e fëmijëve në Kosovë si dhe të fillojë me sukses përfshirjen e aktorëve kyçë siç janë zyrtarët komunalë, bibliotekat, shkollat, mësuesit, fëmijët dhe prindërit. Ky bashkëpunim realizohet në kuadër të projektit "Në nderim të librit për fëmijë", ndërsa projekti do ta avancojë

bashkëpunimin ndërmjet shkollave fillore dhe bibliotekës së qytetit "Latif Berisha", përmes konceptit "Biblioteka e hapur". Komuna e Mitrovicës do ta bëjë financimin e blerjes së librave, TLPK do ta hartojë planin e punës dhe organizimin e punëtorisë me fëmijë, ndërsa Ambasada Suedeze në Kosovë do ta bëjë dhurimin e disa laptopëve për bibliotekën e qytetit (sektorin për fëmijë) dhe aspekte të tjera logjistike.



Kastrati u jep letër falënderimi kompanive për kontributin e dhënë gjatë vërshimeve



KAMENICË, 12 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, së bashku me drejtorin e Drejtorisë për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat, Zotrim Kastrati, si dhe koordinatorin e Shtabit Emergjent Komunal, Hysen Jerliu, kanë takuar përfaqësuesit e kompanive që kanë makineri të rënda e të cilët kanë ndihmuar gjatë kohës së vërshimeve në këtë komunë. I pari i komunës ka thënë se atyre u ka ndarë letër falënderimi për kontributin e dhënë gjatë asaj periudhe. "Sfidat kalohen më lehtë kur jemi të gjithë bashkë. Sot pata

kënaqësinë të takohem me përfaqësuesit e kompanive që kanë makineri të rënda, dhe t'u ndaj letër falënderimi për asistencën dhe kontributin e pashoq gjatë periudhës së vërshimeve në komunën tonë", ka thënë ai. Kastrati ka falënderuar edhe kolegët nga komuna për kontributin dhe punën e pandalshme. Ndërsa drejtori Zotrim Kastrati, duke falënderuar përfaqësuesit e këtyre kompanive, ka theksuar se angazhimi i tyre gjatë periudhës së vërshimeve ka qenë lehtësim dhe ndihmesë edhe për drejtorinë që ai përfaqëson.

Realizohen mbi 370 teste të shpejta për Covid në sheshin "Shatërvan"

PRIZREN, 12 MARS (ER) - Në sheshin "Shatërvan", ekipet mobile të shëndetësisë primare të Komunës së Prizrenit kanë realizuar dje rreth 370 teste të shpejta (rapide) për Covid-19, me qëllim të identifikimit të personave të prekur dhe izolim sa më të shpejtë të tyre, në mënyrë që të parandalohet përhapja e virusit. Me këtë rast, kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka thënë se, përveç QKMF-së dhe QMF-së në Bajram Curr, për shkak të rritjes së numrit të të prekurve nga Covid, javën e kaluar Komuna e Prizrenit ka filluar realizimin e këtyre testeve edhe në QMF-të e fshatrave Gjonaj, Reçanë, Korishë, Zhur si dhe në lagjet "Kurillë" dhe "Tusus", e cila ka mundësuar eliminimin e lëvizjeve të qytetarëve të prekur nga Covid-19. Ndërkaq drejtoresha e Shëndetësisë, Narqize Arënliu-



Hoxhaj, ka njoftuar se ekipet mobile për realizimin e testeve rapide do të jenë të pranishme edhe gjatë ditës së nesërme në sheshin "Shatërvan". Përveç këtyre testeve, Komuna e Prizrenit është komunë që ka

realizuar numrin më të madh të testeve dhe e vetmja që ofron pakon e shërbimeve për Covid-19, ku përfshihen testet rapide, testet serologjike, testet D-Dimer dhe analizat e tjera të nevojshme.

Haziri nderohet me titullin 'Anëtar Nderi' i Fondacionit "Papa Clementi XI-Albani"

GJILAN, 12 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, është nderuar nga Fondacioni "Papa Clementi XI-Albani", me titullin "Anëtar Nderi" i këtij fondacioni. Haziri e ka pranuar këtë mirënjohje me urdhër të presidentit të fondacionit, Zef Bushati, të cilin ia ka

dorëzuar dr. Rabit Sadiku, me motivacionin për kontributin e veçantë për paqen dhe sigurinë në region. Kryetari Haziri e ka falënderuar presidentin e fondacionit ndërkombëtar "Papa Clementi XI-Albani", Zef Bushati, për vlerësimin e lartë që i kanë bërë figurës së tij.



Rritet kostoja e ndërtimit

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Indeksi i Kostos së Ndërtimit (IKN) për tremujorin e katërt (TM4) 2020 ka pasur rritje për 1.1 për qind krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2020

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 MARS - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Kostos së Ndërtimit (IKN) për tremujorin e katërt (TM4) 2020. Sipas ASK-së, Indeksi i Kostos së Ndërtimit në Kosovë (IKN) ka pasur rritje

për 1.1 për qind në TM4 2020, krahasuar me TM3 2020.

Rritje më të madhe kishin: materialet (2.2 për qind); energjia (1.6 për qind); makineritë (0.6 për qind) etj. "Ngritja e çmimeve u neutralizua, kryesisht me uljen e çmimeve te: transporti (- 8.8 për qind); pagat (-0.6 për qind); dhe

kostot e tjera (-0.1 për qind)", është thënë në raportin e ASK-së.

Referuar këtij raporti, krahasuar TM4 2020 me të njëjtën periudhë të vitit paraprak (TM4 2019), Indeksi i Kostos së Ndërtimit pati një rritje prej 1.1-përqindësh. "Ngritja e indeksit kryesisht u vërejt te kategoritë:

materialet (2.3 për qind); energjia (1.9 për qind); dhe makineritë (1.9 për qind). Ngritja e çmimeve u neutralizua, kryesisht me uljen e çmimeve te: transporti (-7.1 për qind), pagat (-2.5 për qind); dhe kostot e tjera (-0.7 për qind)", është thënë në raportin e ASK-së.



Nitaj kishte kërkuar i pari anulimin e zgjedhjes së kryeshefit ekzekutiv të Infrakosit

PRISHTINË, 12 MARS - Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit përmes një komunikate për media ka dhënë sqarim se kush ka kërkuar i pari anulimin e zgjedhjes së kryeshefit ekzekutiv të Infrakosit, ministri në detyrë, Muharrem Nitaj apo Ambasada Britanike. Sipas komunikatës së kësaj ministrie, lajmet e qarkulluara në media, se Nitaj ka kërkuar anulimin pas Ambasadës Britanike, nuk janë të sakta. "Për hir të informimit të drejtë të

opinionit publik, ju njoftojmë se shkrimet e publikuara në disa portale, se 'ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Nitaj, pas reagimit të Ambasadës britanike, kërkon anulimin e zgjedhjes së kryeshefit ekzekutiv të Infrakosit', nuk janë të sakta. Ministri Muharrem Nitaj ka kërkuar anulimin e këtij konkursi përpara se të reagonte Ambasada e Britanisë, reagimi i së cilës ka ardhur më pas, e si mbështetje qëndrimit të

Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit për të mos proceduar zgjedhjen e bordeve të reja të ndërmarrjeve publike, e të cilin e vlerësojmë pa asnjë dyshim. Ne duam të besojmë se gabimi ka qenë i paqëllimshëm, por informimi gjysmak apo gjysmë i vërtetë mund të krijojë pasqyrë të gabuar, duke qenë edhe në kundërshtim me interesin e opinionit publik", është theksuar në komunikatën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.



Tentoi të vjedhë para nga bankomati, arrestohet një person



Prishtinë, 12 mars (ER) - Njësia Policore e Sektorit për Hetime të Krimeve Kibernetike ka arrestuar një person i cili përmes pajisjeve të modifikuara ka tentuar të vjedhë para nga një bankomat i një banke në Prishtinë.

Policia e Kosovës ka

sekustruar disa pajisje që ka përdorur për të pasur qasje në bankomat dhe paratë e nxjerra. "Nga i dyshuari në cilësi të provave materiale janë sekustruar: dy USB, një tastierë kompjuteri, një pajisje e modifikuar për qasje të paautorizuar në bankomat, vegla të ndryshme pune për

mundësimin e qasjes në bankomat, dorëza, shirit ngjitës, para të gatshme (185 euro, 80 franga zvicerane, 100 krona çeke dhe kartela bankare", thuhet në raportin e Policisë së Kosovës.

I dyshuari, pas intervistimit, me vendim të prokurorit, është dërguar në mbajtje.

Përsiatje politike / TRIADA E KOSOVËS (5)

Viti 1981, sidomos pranvera e tij, ka qenë viti i provës për shqiptarët e Kosovës



Shkruan: Bedri ISLAMI

Ramiz Alia ka qenë gjithnjë njeriu enigmë i komunizmit. Asaj kohe nuk e dija se isha borxhli ndaj tij dhe ai vetë nuk më tha gjë. Ose e kishte harruar, ose kishte lënë kohën ta bënte për të.

Kur në vitin 1972 shkrova romanin "Ditët e një qyteti", dhe e dërgova për botim, redaksia e romanit në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri", dërgoi një relacion të gjatë në Komitetin Qendror, që i kaloi edhe Ramiz Alisë. Mes të tjerave, gjatë, shumë gjatë, shkruhej për romanin tim si vepër dekadante dhe mosnjohëse e luftës antifashiste. Thelbi i romanit është historia e një gazetari të ri dhe të dashurës së tij, të cilët kërkojnë të mësojnë historinë e babait të vrarë gjatë luftës, në mënyrë enigmatike, kur ai kishte qenë drejtues i qarkorit të partisë në një qytet jugor. Aluzioni ishte i qartë, kisha menduar se nuk do të kapej nga askush.

Ramiz Alia, në një letër që i dërgonte Pirro Kondit, me shkrim dore, ku dallohej një kaliografi e bukur, si e kishin gjimnazistët e para luftës, ndërsa e porosiste që ndaj dy shkrimtarëve të njohur të merreshin masa, për mua, ndoshta ngaçë kishte qenë mik me babanë tim apo se shtëpitë e Gjylbegjve në Shkodër ishin kulm më kulm me shtëpinë e tij, i shkroi që të dërgohej një kritikë i njohur dhe të ndihmohej. Dallimi i një fjale, "ndëshkim" apo "këshillim", asokohe kishte të bënte me jetën. Nuk e kam falënderuar kurrë. Kur studiuesi Dashnor Kaloçi më dërgoi faksimilet e gjetura në arkivin e KQ, Ramiz Alia nuk ishte më në jetë.

Sidoqoftë, në vitin 1981, ai e drejtoi mrekullisht mirëfushatën e Shqipërisë ndaj Kosovës, aq sa shumë njerëz besonin se po futeshim në luftë, pa qenë në luftë, dhe arriti atë që kishte dashur shefi i tij: ndjenja nacionale kaloi përmbi hallet njerëzore.

Nëse Shqipëria e bëri këtë për të mbuluar gjymtyrët e saj të laskuriqura, apo se ashtu ia ndjeu shpirti, këtë asnjëherë nuk do të mund ta zbulojmë deri në fund. Edhe hapja e arkivave të Komitetit Qendror nuk është se solli diçka vendimtare dhe të patjetërsuar. Është e habitshme se si, në të gjitha mbledhjet e Byrosë Politike apo të Sekretariatit të KQ, është folur me të njëjtën gjuhë dhe ka

pasur të njëjtën mendësi, si ajo që është shkruar më pas. Duke qenë se i gjithë shteti ishte nën një censurë të rreptë dhe të pabesuar për nga kontrolli, ishte e qartë se çdo prononcim, ngado që vinte, që nga shkencëtarët më të shquar dhe deri te barinjët në male, që nga organi kryesor mediatik "Zëri i Popullit" e deri te fletushkat lokale merrej si qëndrim zyrtar dhe trajtohej si i tillë.

Të gjithë e dinin se artikujt e muajit prill 1981, apo ata të disa javëve më pas, kishin dalë nga zyra e Enver Hoxhës. Duke luajtur me enigmën e autorit të panjohur, ai rriste veten, shushaste të tjerët dhe përcaktonte vijën. Jashtë saj nuk mund të dilje, edhe sikur të doje një mijë herë. Në fakt, po krijohesh një kohë me heronj të rremë dhe, të rremët, janë më të rezikshëm, sepse janë të padukshëm. Por më

ishte menduar, 17 vite më pas, në qershorin e vitit 1999. Them se ka qenë një vit prove, sepse, në strukturat iluzore që kishte krijuar regjimi i Beogradit, do të ngrihej një brez, i cili nuk do të ishte kursesi i humbur, për të çuar më tej atë që kishin dashur etërit e tyre. Ky brez, thellësisht romantik dhe krejtësisht atdhetar, doli nëpër rrugë për të filluar një jetë ndryshe. Ishte një brez që dëshmoi historikisht se, në Kosovë, nuk kishte humbur asgjë dhe se kështu nuk mund të vazhdohej më.

Pas dhunës së tankeve, Beogradi njoftoi për 11 të vrarë. Një shërbëtor i tyre në Prishtinë, Vllasi, tha se ishin vrarë vetëm nëntë vetë. Nëse kishte filluar kështu gjakshëm, nuk do të kishte të ndalur. Romantikës dhe atdhedashurisë së një brezi të ri, Beogradi i kundërvuri tanket, dhunën policore, vrasjet,

apo nuk e pranojmë, fakt është se ata këtë mbështetje e kërkonin dhe e prisnin nga shteti amë, Shqipëria. Heshtja e Kosovës i çoi ata drejt fjalës së Shqipërisë. Kryengritja shqiptare në ish-Jugosllavi, në fillimin e viteve '80 ka qenë, padyshim, njëra nga ngjarjet më cilësore dhe për të cilën janë bërë analiza të shumta. Me të janë marrë e, sigurisht, do të merren njerëz të mendimit nga të gjitha fushat, por njëkohësisht edhe spekulues; janë marrë shkrimtarë e sociologë, historianë, protagonistë e gazetarë. Janë ringritur ngjarjet, duke filluar që nga mbrëmja e 11 marsit dhe deri tek arrestimet masive; janë ngritur teza të ndryshme, hipoteza të sakta e nga më të çuditshmet; ka pasur gjykime e paragjykime, hamendje halucionante, të sakta dhe nga më të pazakonshmet; ka pasur fillimisht çjerreje dhe përbaltim

parë, ata nuk duken edhe aq interesantë, ata nuk përbejnë 'ngjarje', pra nuk mbajnë në vete ankthin e zbulimit të së vërtetës, nuk përbëjnë lajm, nuk kanë mister... ndonëse kjo nuk është aspak e vërtetë. Ndoshta më shumë se kudo tjetër, tek njerëzit e zakonshëm, politika bën vend nëpërmjet shfaqjeve që nuk janë edhe aq të dukshme politikisht, por që në të vërtetë bëjnë vetë thelbin e politikës.

Le të sjell dy shembuj të mëvonshëm. Në vitin 1991, pas lëvizjes studentore dhe ndryshimeve jetike politike në Shqipëri, të dy partitë e mëdha, si ajo demokratike ashtu edhe ajo socialiste, në programin e tyre elektoral përfshinë edhe bashkimin kombëtar të shqiptarëve. Partia Demokratike e kishte shumë më të theksuar e shumë më të dukshme këtë pikë sa u krijua ideja, se, pas fitores së saj, zgjidhja e çështjes kombëtare shqiptare ishte punë e disa pak kohëve. Afishimi i tepruar i këtij koncepti nuk e pengoi këtë forcë politike, përkundrazi e ndihmoi që, në votimet e 22 marsit 1992, të merrte rreth 70 për qind të votave të shqiptarëve.

Katër vite më pas, të dy partitë e mëdha politike shqiptare, krejt ndryshe nga katër vite më parë, nuk e përmendnin as në kontekstin me të largët çështjen e bashkimit kombëtar të shqiptarëve dhe vetë Kosova kalonte në planin e dhjetë. Kjo sepse, të dy partitë politike e dinin se, në rrethanat e krijuara, afishimi i një qëndrimi të tillë sillte humbjen e votave.

Disa muaj para zgjedhjeve politike të majit 1996 në Shqipëri, së bashku me një nga drejtuesit e lartë socialistë të kohës, që ishte edhe nënkryetar i Parlamentit, mikun e vjetër, Shaqir Vukaj, shkuam të rrinin në shtëpinë e Fehmi Lladrovcit. Lart, në banesën e tij, në Haar, pjesë e qytetit të madh të Mynihut, ulur në shilte, në një kohë kur sapo kishin nisur aksionet e para të organizuara dhe të njësura të UÇK-së, po bisedohej për gjithçka që kishte lidhje me Kosovën. Befas, Fehmiu, i drejtpërdrejtë si ishte, pyeti mikun:

- Ju, socialistët, a do e keni në programin tuaj bashkimin e shqiptarëve?

- Jo, - u përgjigj sinqerisht Shaqiri. - Nuk do e kemi.

- Pse? - e pyeti Fehmiu. - Humbni vota nëse e keni apo çfarë?

- Humbim vota, - pranoi sinqerisht Vukaj.

- S'paskeni qenë gjë as ju socialistët! Për besë, atyre që ndërrojnë kaq shpejt nuk u duhet zënë besë, e ju, si bukur shpesh po ndërroini.

Shaqiri e kuptoi dhe nuk foli, e u bë në miq të mirë. (Vijon)



shumë, me heronj të vetëshpallur, pra të dëmshtëm.

Pa as më të voglin dyshim, viti 1981 dhe, sidomos pranvera e tij, ka qenë viti i provës për shqiptarët e Kosovës.

Përgjithësisht, secila dekadë e ka gurin e vet themeltar, ose më saktë, ka një datë ose një moment të caktuar, që vendos pikëmbështetjet e së ardhmes. Për shqiptarët në Kosovë ka ndodhur disa ndryshe: një ngjarje ka mbajtur mbi vete më shumë se dy dekada dhe si duket, do të vazhdojë të mbajë mbi vete edhe shumë vite të tjerë. Demonstratat e pranverës, mars - prill 1981, janë pikënyja e viteve që erdhën më pas dhe, si të tilla, ata kanë mbetur në kujtesën e kombit dhe në dëshminë historike të tij. Prej këtij viti, duam apo nuk duam, jemi të vetëdijshëm ose jo, kanë rrjedhur të gjitha ngjarjet e tjera madhore që lidhen me Kosovën dhe, një pjesë e rëndësishme e tyre, edhe me Shqipërinë londineze.

Viti 1981, me pranverën që nisi më 11 mars, për të shkruar më pas tek ditët e 26 marsit, 1 dhe 2 prillit, mbante në vete farën e hedhur të shumë ditëve të ardhshme, që dha fryt, shumë më tepër se sa

burgimet, arrestimet, gjakimet, dënimet e ashpra, dhe, si të mos mjaftonte e gjithë kjo, filloi procesin e jashtëzakonshëm fëlliqës të diferencimit.

Kërkohej të diferenciohej vëllai nga vëllai, ati nga djemtë, fëmijët nga prindërit, miqtë nga mikun, shokët nga shoku, të afërmit nga të largët, të zakonshmit nga të pazakonshmit, kërkohej të bëhej gjithçka e diferencuar.

Dosjet e diferencimit janë diku, por, mbi të gjitha, janë njerëzit që kanë mbajtur mbi supet e vet gjithë barrën e këtij diferencimi. Gjithçka që donte të krijonte regjimi i Beograd-Prishtinës qëndronte në mundësinë që, të pazakonshmit të ishin të huaj për Kosovën, të lëçiturit e saj; ndërsa pushtimi, si i zakonshëm, të kishte të drejtën e qytetarisë.

Këto njerëz, të pazakonshmit, të prangosur, të gjakuar, ashtu si edhe të afërmit e tyre, djemtë apo vajzat nëpër burgjet serbe, u ndjenë të vetmuar, qoftë edhe përkohësisht. Megjithatë, të dy pjesët, edhe ata që ishin jashtë e të burgosur, edhe ata që ishin të burgosur e me mendimin se çfarë do të bënin më tej, kur të ishin të lirë, kishin në atë kohë një shpresë, një sfond ku mbështetej halli i tyre, kishin momentin e tyre të pritjes për mbështetjen. Duam apo nuk duam sot, e pranojmë

institucional, pastaj heshtje, por kurrë mbrojtje institucionale në Kosovë.

Tezat, hipotezat, pikëpyetjet, debatet, nga më të ashprat e më të vrullshmit, kanë qenë për rolin dhe qëndrimin e shtetit shqiptar. Që në fillim, janë hedhur të gjitha pyetjet e mundshme dhe janë synuar të gjithë dilemat hipotetike. Në të vërtetë, është bërë përpjekja, herë serioze dhe herë e rreme, për të sqaruar disa nga momentet më thelbësore të qëndrimit të shtetit shqiptar ose për t'i përbaltur ato. Pak ose aspak kanë qenë përpjekjet për të ditur gjykimin e njerëzve të zakonshëm në Shqipëri, apo atë të mendimit intelektual. Vërtet si i kanë pritur ata ngjarjet e pranverës kosovare; si kanë depërtuar ato në thelbin e jetës së tyre të zakonshme? Ishte merak spontan, njerëzor a i organizuar, apo e vërteta qëndron diku në mesin e tyre? Kishte më shumë se hall, brengë, shqetësim a mëzë? Kishte diçka më shumë ndaj vetes dhe përtej së zakonshmes? Kishte thjeshtë brengë njerëzore apo edhe kombëtare?...

Tek qëndrimi i njerëzve të thjeshtë, ndoshta asnjëherë, nuk është shprehur si duhet mendimi i sociologëve, gazetarëve, dijetarëve, sepse, në pamjen e



PRANVERA E VETMISË SË MADHE TË UÇK-së



Shkruan: Ismail SYLA

1. Pas 22 vitesh po shënohet Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës pa mundësinë e nderimit të varrezat e dëshmorëve në Prekaz nga katër figura madhore dhe të rëndësishme të historisë së re të Kosovës. Pa nderimet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

2. Këta emra qëndrojnë prapa grilave të një burgu absurd, me të vetmen fajësi: se u angazhuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, se me punën dhe vizionin e tyre përmbysën ëndrrën e Beogradit për ta sunduar përjetë Kosovën. Synimin e tyre dhe të shumë brezave pararendës e mbështeti pjesa më demokratike e botës.

3. Këta emra të kujtojnë 40 vjetorin e Pranverës së Madhe 1981, kur filloi një valë arrestimesh e burgosjesh pas demonstratave që u bënë platformë e pashmangshme

drejt realizimit të Republikës së Kosovës për rreth 20 vjet me radhë. Secila nga katër dekadat kanë profilin e tyre, tashmë histori që po hyn në gjysmëshekullin e saj.

4. Emrat që sot qëndrojnë prapa grilave në Hagë do ta kenë statusin e të burgosurve politikë shqiptarë në rang ndërkombëtar. Ata, aktualisht janë në vetminë e tyre më të madhe. Asgjë nuk është dera e mbyllur, as efekti i pandemisë

së corona virusit, as pamundësia e vizitave të anëtarëve të familjes, sa është braktisja institucionale e tyre.

5. Emrat e të burgosurve në Hagë ta kujtojnë pozicionin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në ofensivat e verës dhe vjeshtës 1998, kur Serbisë iu dha dritë e gjelbër për ta shkatërruar UÇK-në. Sado e dëmtuar dhe e traumatizuar aso kohe, Ushtria Çlirimtare nuk u zhbë, Serbia nuk arriti ta

shkatërrojë dot. UÇK-ja e mblodhi veten dhe doli fituese e luftës për liri.

6. Emrat e të burgosurve janë në kulmin e vetmisë së tyre. Nuk ka parlament, nuk ka qeveri nuk ka presidencë të Kosovës që i mbron ata. Nuk ka OJQ as organizata kombëtare dhe ndërkombëtare që e ngrisin zërin për t'i mbrojtur me seriozitet dhe dinjitetshëm ata (përfashto shoqatat e dala nga lufta, siç thuhet me një

shprehje zhargonike).

7. Emrat që sot nuk mund të bëjnë nderime te varri i Komandantit Legjendar Adem Jashari, te varret e Jasharëve të shumtë dhe të të rënëve të tjerë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, ashtu si Ushtria Çlirimtare e Kosovës që u mbijetoi ofensivave të verës dhe vjeshtës 1998, do ta përballojnë vetminë e madhe aktuale dhe do të dalin ngadhënjimtarë.



EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
 'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82**

Prishtina shkon për fitore në Drenas

Leonit Abazi ka thënë se FC Prishtina synon fitoren ndaj Feronikeli në kuadër të javës së 25-të e cila zhvillohet sot (e shtunë) në Drenas. "Përballja me Feronikelin mbase do të jetë ndeshja më e vështirë deri tani sepse është ekip i fortë dhe me shumë kualitete. Por, pa asnjë dyshim pres fitoren e radhës dhe të vazhdojmë me këtë ritëm. E vërtetë që po gëzoj formë të lartë, e që mendoj se është meritë e gjithë bashkëlojtarëve dhe shpresoj sa më gjatë të jap më të mirën për ekipin", ka thënë Abazi

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINE, 12 MARS - FC Prishtina formën e mirë që po gëzon në sezonin pranveror synon ta vazhdojë edhe në ndeshjen kundër Feronikelit e cila zhvillohet sot (e shtunë) në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas.

Kryeqytetasit janë në garë për titull, ndërsa "Nikli" ka mbetur shumë pas me pikë dhe i duhet të jetë i kujdesshëm nëse nuk dëshiron të largohet nga elita.

Futbollisti Leonit Abazi e ka vlerësuar të vështirë përballjen me klubin nga Drenasi, por ka thënë se Prishtina synon maksimumin e pikëve. "Përballja me Feronikelin mbase do të jetë ndeshja më e vështirë deri tani sepse është ekip i fortë dhe me shumë kualitete. Por, pa asnjë dyshim pres fitoren e radhës dhe të vazhdojmë me këtë ritëm. E vërtetë që po gëzoj formë të lartë, e që mendoj se është meritë e gjithë bashkëlojtarëve dhe shpresoj sa më gjatë të jap më të mirën për ekipin", ka thënë Abazi.

Sot me fillim nga ora 13:00 zhvillohet edhe ndeshja tjetër e javës së 25-të në mes të Besës dhe Llapit. Pejanët janë të fundit në tabelë dhe edicionin e ardhshme do



të bëjnë gara në Ligën e Parë, kurse Llapi synon t'iu rikthehet fitoreve për faktin se ndeshjen e fundit luajti baras kundër Drenicës (3-3).

Edhe skuadra e Tahir Batatinës në sezonin pranveror është duke kaluar nëpër një formë të mirë, ani pse renditet në pjesën e poshtme të tabelës. Ndërsa të dielën zhvillohet derbi i kësaj xhiro ku në Suharekë, Ballkani i vendit të dytë e pret skuadrën kampione dhe lideren aktuale, Dritën. Nëse skuadra e drejtuar nga Blendi Shkëmbi e fiton

këtë ndeshje derbi, atëherë do ta marrë kryesimin. Drita udhëton me synim për të marrë një rezultat pozitiv.

Ndeshje interesante pritet të jetë edhe ajo në mes të Gjilanit dhe Trepçës '89, ku pritet të debutojë Ismet Munishi në bankinën e Gjilanit. Kësaj skuadre janë duke i munguar rezultatet pozitive në sezonin pranveror dhe tash me trajnerin e ri shpreson këndelljen. Ndeshja e pestë është ajo në mes të Drenicës dhe Arbërisë.

SHKURT

Shqipëria më 5 qershor zhvillon miqësore ndaj Çekisë

Dy miqësore për Shqipërinë në muajin qershor. Kombëtarja kuqezi do të përballlet me Uellsin më datë 5 qershor në "Cardiff City Stadium" (18:00), kurse tri ditë më pas (8 mars) do të përballlet me Republikën e Çekisë. Sfida do të luhet në Pragë, kryeqytetin e Çekisë, teksa kjo do të jetë ndeshja e parë në histori e Shqipërisë kundër këtij kundërshtari. Ora e nisjes së ndeshjes dhe stadiumi mbeten të përcaktohen në javët në vijim. Në të kaluarën kombëtarja shqiptare ka zhvilluar pesë duele me Çekoslovakinë, nga të cilat tri miqësore dhe dy ndeshje të vlefshme për eliminatorët e Kampionatit Evropian.

Sylejmani edhe një mandat në krye të FAK-ut

Halil Sylejmani do ta udhëheqë edhe për një mandat katërvjeçar Federatën e Atletikës së Kosovës. Në Kuvendin e rregullt zgjedhor të FAK-ut, Sylejmani mori përkrahje absolute. Me vota të kuvendarëve, në Bordin e FAK-ut janë zgjedhur: Adrian Mazreku, Remzije Shala, Xavit Tahiri, Faik Sylejmani, Kadri Kaçanolli, Gazi Renaku, Faik Balić, kurse në Këshillin Mbikëqyrës janë zgjedhur Adnan Tahiri, Driton Haliti, Mehmet Berisha. Atmosfera në Kuvendin e rregullt Zgjedhor ishte shumë konstruktive. Të gjitha raportet janë aprovuar pa asnjë vërejtje nga kuvendarët. Të pranishëm në Kuvendin ishin edhe përfaqësuesit e MKRS-së, Afërdita Fazlija dhe i KOK-ut, Shasivar Haxhijaj, që kanë lavdëruar punën e bërë nga Federata e Atletikës e Kosovës. Para kuvendarëve kryetari Sylejmani ka folur për sukseset e arritura gjatë viteve të kaluara si dhe për planet dhe synimet për mandatin e ardhshëm.

Liburni - Liqeni, finalja e Kupës në futsal

Liburni nga Gjakova dhe Liqeni nga Drenasi janë dy skuadrat finaliste të Kupës së Kosovës në futsal. Liburni qysh në ndeshjen e parë e kishte zgjidhur çështjen e kualifikimit, pasi e kishte mposhtur BB Llapin në Podujevë me rezultat 7:2, prandaj në ndeshjen e kthimit luajti me komoditet, duke shënuar fitore me rezultat 3:1. Ndërkohë, shumë më interesante ishte përballja në kryeqytet ndërmjet Prishtinës dhe Liqenit, ku skuadra nga Drenasi arriti ta përmbysë epërsinë e prishtinasve nga ndeshja e parë (4:5), duke fituar me rezultat 4:2. Ndeshja finale e kësaj gare do të zhvillohet në muajin prill në kryeqytet.

SUPERLIGA - Java e 25

Të shtunën takohen:
 13:00 Feronikeli - Prishtina
 13:00 Besa - Llapi

Të dielën takohen:
 13:00 Ballkani - Drita
 13:00 Drenica - Arbëria
 13:00 Gjilani - Trepça '89

Sokoli ndahet me Gjilanin, Munishi emërohet trajner i ri

GJILAN, 12 MARS (ER) - Bylbyl Sokoli i ka ndarë rrugët me skuadrën e Gjilanit si pasojë e rezultateve të dobëta. Humbja që pësoi Gjilani të enjten në derbi kundër Dritës ishte vendimtare në vendimin e Sokolit për dorëheqje nga posti i trajnerit. "Mbyllja e bashkëpunimit me trajnerin vjen pas rezultateve jo të mira pas fillimit të

pjesës pranverore në kupë dhe kampionat, me ç'rast dorëheqja nga Bylbyl Sokoli u aprovua nga klubi ynë, duke e liruar atë nga detyra e trajnerit. Klubi e falënderon për punën trajnerin e deritanishëm, Bylbyl Sokoli, dhe i uron suksese për vazhdimin e karrierës së tij si trajner", thuhet në njoftimin e Gjilanit.

Skuadra e Gjilanit nuk ka humbur kohë dhe të premtën e ka emëruar trajner të ri Ismet Munishin. Lajmin e ka konfirmuar presidenti i kësaj skuadre, Florim Zuka, i cili fotografinë e postuar në profilin e vet në "Facebook", me trajnerin Ismet Munishi, e ka përcjellë me mbishkrimin: "Ismeti drejton SC Gjilanin".



Mick Schumacher: Dua të mësoj sa më shumë, pastaj të tregoj se mund të bëhem më i miri, si babai im

BERLIN, 12 MARS - Debutimi i Mick Schumacherit në Formula 1 do të jetë një nga arsyet kryesore të shtimit të interesit për këtë sport këtë sezon. 21-vjeçari gjerman, djali i legjendës Michael Schumacher, do të garojë me makinën amerikane Haas.

Në një intervistë nga Bahrein, ku kanë nisur testet dimërore, ai nuk fsheh ambiciet e tij. "Natyrishë se historia më interesante e këtij viti në Formula 1 do të jem unë. Gjithsesi, unë e di se çfarë do të thotë të jesh pjesë e Formulës 1. Jam i

lumtur dhe njëkohësisht krenar, për veten dhe për skuadrën time, për atë që kemi bërë. Jam këtu për të treguar se sa vlej", ka thënë Mick Schumacher. "Shpresoj që në këtë sport të qëndroj sa më gjatë dhe për t'ia dalë mbanë. Do të punoj në

maksimumin tim për t'u bërë më i miri. Ky vit do të jetë i rëndësishëm për mua, për të mësuar sa më shumë dhe më pas do të kem mundësinë të tregoj se mund të bëhem më i miri, si babai im", ka deklaruar Mick Schumacher.



Në Mitrovicë takohen rivalët e vjetër

PRISHTINË, 12 MARS - Në fundjavë do të zhvillohet xhironja e 23-të në FIVE STAR Superligën e Kosovës në basketboll. Sfida e parë do të zhvillohet ndërmjet dy rivalëve të vjetër në basketbollin e Kosovës, Trepçës dhe Sigal Prishtinës. Mitrovicasit janë në formë të mirë, ku kanë shënuar pesë fitore radhazi dhe do të përpiqen të vazhdojnë me fitore përballë prishtinasve, që në xhiron e fundit mundën Pejën. Përballja do të jetë shumë interesante për shkak se skuadrat ndodhen në pozitë jo të dëshirueshme, ku mitrovicasit janë në vendin e gjashtë me 31 pikë, kurse kryeqytetasit në vendin e shtatë me një pikë më pak. Bashkimi, që nuk është në formë të mirë përballë me Golden Eagle Yllin, që në xhiron e fundit pësoi humbje nga Ponte Prizreni. Prizrenasit ndodhen në vendin e pestë me 32 pikë, derisa therandasit në vendin e



dytë me katër pikë më shumë. Takim shumë interesant pritet të jetë mes Rahovecit dhe Pejës. "Vreshtarët" janë në vendin e tretë me 33 pikë, një më shumë se pejanët, që renditen në vendin e katërt dhe në takimet e fundit nuk kanë arritur rezultate pozitive. Përballja e fundit do të jetë mes vendit të parë, Ponte Prizrenit dhe vendit të fundit, Vëllaznimit. Prizrenasit janë liderë me 37 pikë, kurse kuqezinjtë kanë grumbulluar 29

pikë, por në tri xhiron e fundit kanë mundur Sigal Prishtinën, Pejën dhe Rahovecin.

FIVE STAR Superliga - Java 23

Të shtunën takohen:
17:00 Trepça - Sigal Prishtina
19:00 Bashkimi - Golden Eagle Ylli

Të dielën takohen:
17:00 Rahoveci - Peja
19:00 Ponte Prizreni - Vëllaznimi

Brooklyni mposhti Bostonin, fitojnë Clippersat dhe Miami

BROOKLYN, 12 MARS - Brooklyn Nets afrohet gjithnjë më shumë me vendin e parë në Konferencën e Lindjes. Skuadra njujorkeze prishi ecurinë pozitive të Boston Celticsit duke triumfuar pa shumë vështirësi përballë 17 herë kampionëve të NBA-s me rezultatin 121-109. Bostoni, edhe pse vinte nga katër fitore radhazi në këtë sfidë, u dorëzua pa kushte përballë një prej skuadrave pretendente për titullin kampion në këtë sezon të NBA-s. Në mungesë të Kevin Durantit dhe Blake Griffinitiferencën për Netsin në këtë sfidë e bëri dyshja Irving - Harden. I pari shkëlqeu me 40 pikë, 8 rebounde dhe 3 asistime, ndërkohë që Hardeni shtoi 22 pikë në suksesin e 23-të sezonal të Brooklynit. Për Celticsin më i miri mbi parket rezultoi Jason Tatum me 31 pikë. U rikthye te sukcesi Los Angeles Clippers që mori një fitore bindëse përballë Golden State Warriorsit me rezultatin 130-104, duke zhytur në krizë pikërisht skuadrën nga San Francisco që pësoi humbjen e 4-të rresht. Heroi i kalifornianëve në këtë sfidë ishte i përherëshmi Kawhi Leonard me



28 pikë. Vijon forma e shkëlqyer për Milwaukee Bucksin që mori fitoren e 7-të në 8 ndeshjet e fundit pasi kaloi lehtësisht me rezultatin 134-101 New York Knicksin. Greku Giannis Antetokounmpo me një triple-double, pasi koleksionoi 24 pikë, 10 rebounde dhe 10 asiste, ishte basketbollisti më i mirë mbi parket për Bucksin dhe që e udhëhoqi skuadrën nga Wisconsin drejt suksesit të 23-të sezonal në 37 takime që ka zhvilluar në total. Edhe Miami Heat po kalon një moment të artë. Nënkampionët e edicionit të kaluar, morën fitoren e 8-të në 10 ndeshjet e fundit pasi mposhtën

Orlando Magic me rezultatin 111-103. Jimmy Butler me 27 pikë dhe 8 rikuperime poshtë tabelës dhe 11 asistime ishte basketbollisti që spikati më shumë te Heati në këtë sfidë.

REZULTATET

Charlotte Hornets - Detroit Pistons	105-102
Brooklyn Nets - Boston Celtics	121-109
Toronto Raptors - Atlanta Hawks	120-121
Chicago Bulls - Philadelphia 76ers	105-127
Miami Heat - Orlando Magic	111-103
Milwaukee Bucks - New York Knicks	134-101
New Orleans Pelicans - Minnesota Timberwolves	105-135
Oklahoma City Th. - Dallas Mavericks	116-108
LA Clippers - Golden State Warriors	130-104
Portland Trail Blazers - Phoenix Suns	121-127
Sacramento Kings - Houston Rockets	125-105

SHKURT

West Hami vihet pas Strakoshës

Thomas Strakosha po kalon një sezon shumë të vështirë te Lazio, teksa ka humbur vendin e titullarit, i cili tashmë mbahet nga Pepe Reina. E ardhmja e Strakoshës mund të jetë në Premierë Ligë. Sipas asaj që raporton "Il Messaggero", gardiani kuqezi ndiqet edhe në Premierë Ligë nga skuadra e West Hamit. Drejtuesit e këtyre të fundit e pëlqejnë lojtarin dhe po përgatitin një ofertë për të, në mënyrë që ta marrin në skuadrën e tyre. Kujtojmë se Strakoshës i përfundon kontrata me Lazion në verën e vitit tjetër.

Agjenti i Ronaldos, në bisedime me Realin

Zërat e largimit të Cristiano Ronaldos nga Juventusit në fund të sezonit po shtohen nga ditë në ditë. Dështimi i radhës në Ligën e Kampionëve me bardhezinjtë e ka zemëruar fituesin e pesë "Topave të Artë", i cili dëshiron të nisë një aventurë të re. "Marca" dhe "AS" raportojnë se Jorge Mendes, agjenti i sulmuesit 36-vjeçar, po negocion me Florentino Perez, kreun e "Los Blancos". Për momentin bëhet fjalë vetëm për sondazhe dhe bisedime paraprake për të mësuar nëse ekziston mundësia e rikthimit te Reali. CR7 do të ishte i mirëpritur në "Santiago Bernabeu", aty ku shkëlqeu dhe fitoi gjatë nëntë sezoneve që veshi fanellën e kampionëve të Spanjës (2009-2018). Dy opsionet e tjera për të ardhmen e portugezit janë Manchester Unitedi dhe PSG-ja. Opsioni i dytë duket më i mundshëm, por mund të ndodhë vetëm nëse largohet Mbappe nga Parisi.

Formacioni i javës në Ligën e Evropës

Të enjten u zhvillua faza e 16 e finales në Ligën e Evropës dhe një ditë më pas është publikuar edhe formacioni më i mirë i javës. UEFA ka bërë publikimin e formacionit më të mirë të kësaj jave në Ligën e Evropës. Gjatë ditës së djeshme, nuk pati shumë befasi në ndeshjet e Ligës së Evropës, përpos barazimit mes Milanit dhe Manchester Unitedit kur këta të fundit konsideroheshin favoritë për ta fituar ndeshjen. Harry Kane është shpallur lojtari më i mirë i kësaj jave, kur edhe shënoi dy gola në ndeshjen ndaj Dinamo Zagrebit. Formacioni: Rui Silva, Aurier, Gabriel, Raul Albiol, Tahliafico, Odegaard, Pellegrini, Gravenberch, Soldado, Kane, Tadiç.

Stoichkov: Barça duhet ta shesë Griezmannin

Antoine Griezmann është një nga blerjet më të shtrenjta në historinë e Barcelonës, por ende nuk i ka justifikuar aspak paratë e derdhura për blerjen e tij. Hristo Stoichkov ka kritikë të ashpra për Griezmann dhe shprehet se skuadra katalanase luan me 10 veta kur francezi është në fushë. "Kurdoherë që Griezmann është në fushë, Barcelona luan 10 lojtarë. Nëse drejtuesit duan të bëjnë diçka në planin afatgjatë, duhet ta shesin atë. Trincao dhe Braithwaite duhet të qëndrojnë në ekip. Çfarë po bën Griezmann atje", u shpreh Hristo Stoichkov.

Pioli: Jemi në rrugën e duhur për ta rikthyer Milanin e madh

Trajneri i Milanit, Stefano Pioli, u shfaq mjaft i kënaqur me paraqitjen e kuqezinjeve në ndeshjen kundër Manchester Unitedit (1-1). Ai ka thënë se janë në rrugën e duhur për ta rikthyer Milanin e madh. "Jam shumë i kënaqur me paraqitjen e futbollistëve të mi, që luajtën me autoritet dhe mbajtën kontrollin e lojës, përballë një kundërshtari vërtet të fortë. E dinim që na pret një ndeshje e vështirë, por unë stërvit një ekip me djem të shkëlqyer dhe takime e paraqitje si kjo na rritin edhe më shumë vetëdijen për forcën tonë. Jemi në rrugën e duhur për ta rikthyer Milanin e madh", ka thënë Pioli.



Republika e Kosovës

Komuna e Malishevës

Drejtoria Për Arsim dhe Edukim



Nr: 11/324

Më: 10.03.2021

Në bazë të Ligjit për Zyrarët Publik Nr. 06/L-114, Kapitullit V nenit 67 dhe 68, e në bazë Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr:151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo- Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratave dhe Emërimit të Përkohshme, si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2019, për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes të drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucioneve edukativo – arsimore dhe aftësuese, Drejtoria Komunale e Arsimit në Malishevë,shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lirë të punës

Nr	Niveli, Shkolla	Vendi	Titulli mbikëqyrës	Lloji i pozitave	Titulli i punës	Koeficienti:	Orë: në javë	Kohëzgjatja emërimit
1	SHFMU "Afrim Krasniqi"	Bardh	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
2	SHFMU "Asim Vokshi"	Panorc	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
3	SHFMU "Bajram Curri"	Drenoc	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
4	SHFMU "Dëshmorët e Fshatit"	Bubavec	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
5	SHFMU "Emin Duraku"	Dragobil	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
6	SHFMU "Ganimete Terbeshi"	Astrazup	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
7	SHFMU "Gjergj Kastrioti"	Vermicë	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
8	SHFMU "Ibrahim Mazreku"	Malishevë	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
9	SHFMU "Ismail Qemali"	Bellanicë	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
10	SHFMU "Labinot Krasniqi"	Mirushë	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
11	SHFMU "Nuhi Mazreku"	Guriç	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
12	SHFMU "Ramadan Morina"	Damanek	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
13	SHFMU "Tafil Kelmendi"	Balincë	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
14	SHFMU "Naim Frashëri"	Banjë	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
15	Gjimnazi "Hamdi Berisha"	Malishevë	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	8.4	40	4 (katër) vite
16	SHML "Lasgush Poradeci"	Kijevë	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	8.4	40	4 (katër) vite

Qëllimi i vendit të punës:

Menaxhimi, organizimi dhe mbikëqyrja e procesit arsimor në institucionin edukativo-arsimor.

Detyrat Kryesore:

- Zbatimi i ligjshmërisë në fushën e arsimit;
- Zhvillimin e një plani afatgjatë për aktivitetin e drejtorisë;
- Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore,
- Aftësimin e personelit në Institucion,
- Planifikimin dhe shfrytëzimin racional të buxhetit,
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen, vlerësimin, disiplinën dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit,
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit të informimit për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlkuara të praktikës,
- Caktimin e masave disiplinore ndaj nxënësve,
- Planifikimin, udhëheqjen dhe koordinimin e të gjitha aktiviteteve në institucion,
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes këtij ligji dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

Kushtet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit,
- 1. Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsimi (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar),
- 2. Master arsimor (kualifikimi prej 300 ECTS, së paku 5 vite shkollim universitar),
- 3. Katërvjeçar (kualifikim prej 240 ECTS, së paku 4 vite të shkollimit universitar)
- 4. Bachelor katërvjeçar (kualifikimi prej 240 ECTS, së paku 4 vite të shkollimit universitar), Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve,
- Të ketë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsimi të aprovuar nga MASH, sipas rekomandimit KSHL,
- Të ketë përvojë pune në procesin edukativ – arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës,
- 1. Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për arsimin e mesëm të lartë,
- 2. Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët në nivele tjera,

Dokumentet e nevojshme që kërkohen:

1. Certifikata e lindjes, (kopje);
2. Diploma e fakultetit të kryer për nivelin përkatës, (kopje);
4. Dëshmi mbi përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor,(kopje);
5. Portofolin profesional , me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/ formularin H të këtij UA;

6. Letër referencë nga një institucion publik kredibile (si Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, DKA, Këshilli Drejtues i Shkollës, punëdhënësi paraprak, Institucionet e Arsimit të lartë);

7. Letrat e referencës duhet të ketë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake;

8. Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues për të cilin ka konkurruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12: Arial) sipas udhëzimeve të MASHT-it,

9. Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion shëndetësor i licencuar më të cilin dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;

10. Dëshmi që nuk është nën hetime, dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët (origjinal);

11. Kopja e letërnjoftimit.

12. Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë;

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbim me Qytetar në Komunën e Malishevës. Data e njoftimit në web faqen: <https://kk.rks-gov.net/malisheve/category/shpalljet>, <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>, është prej dt; 10.03.2021 deri me dt, 08.04.2021, ndërsa data e aplikimit është nga dt; 09.04.2021 deri me dt; 23.04.2021. Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të shqyrtohen nga Komisioni, ndërsa në intervistë do të ftohën vetëm kandidatët nga lista e ngushtë.

Të gjithë kandidatët që kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kushte të konkursit.

Rezultatet shpallën në linkun: <https://kk.rks-gov.net/malisheve/category/shpalljet/konkurset/>

Malishevë: 10.03.2021

Drejtori i Arsimit

Blerim Thaçi



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjizë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti


AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

『nga Moisiu deri te Kieślowski』

ÇMIMI: 5.99 €



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë





**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**

SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE (SPN)

Country	Kosovo
Project Name	Threshold Program
Procurement Title	Supply, Installation, Maintenance of relevant equipment and services for the introduction of consumption-based heat metering and thermostatic heating valves in District Heating, Prishtina
Procurement Ref. Number	BD / QPBS / 2021/003
Type of Procurement (goods, works or services as applicable)	Procurement of Goods and Related Services
Employer	Millennium Foundation of Kosovo (MFK)
Publication Date	11 March 2021
Submission Deadline	22 April 2021; 14:00 pm (Kosovo Time)

The Millennium Foundation Kosovo has received financing from the Millennium Challenge Corporation toward the cost of the "Threshold Program agreement", and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for Supply, Installation, Maintenance of relevant equipment and services for the introduction of consumption-based heat metering and thermostatic heating valves in District Heating, Prishtina.

MCC's funding is appropriated by the U.S. Congress and obligated to the threshold program upfront, with no incremental or partial funding. So when a contract is signed with an MCA Entity, money is already available to the MCA Entity and, for most contracts, invoices are paid directly to Contractors/Consultants/Suppliers by the US Treasury. MFK now invites password protected bids from eligible Bidders to submit Bids (containing separate envelopes for the Technical Offers and the Financial Offers) for the provision of: supply, installation and maintenance of control- and metering equipment for all the existing clients of District Heating Company Termokos in Prishtina; billing and networking solution in conjunction with above-mentioned equipment; any necessary capacity building of Termokos employees. The Contract contains different modification and adaption works on the internal building heating system. Depending on the internal heating system configuration (dual pipe system and vertical/ horizontal system) of each building the parts (as stated in Section V – Schedule of Requirement) of the system could be affected and need an update and/ or must be refitted with new equipment. More details on these goods and related services are provided in the Schedule of Requirements in the bidding document associated with this BD (the "Bidding Document").

Bidding will be conducted through the Quality and Price Based Selection ("QPBS") procedures as specified in the MCC Program Procurement Guidelines (PPG), and is open to all eligible bidders or consultants as defined in the PPG.

A Pre-Bid Conference will be held at 14:00 (Kosovo time) on 23 March 2021 only through online Zoom Meeting. Attendance is strongly advised for all prospective bidders or their representatives but is not mandatory.

Zoom Meeting Link: <https://us02web.zoom.us/j/83157535797>

A complete set of bidding documents (BD) including any clarifications, notices and/or addendums may be obtained by interested eligible bidders through the following website (eventual clarifications or any changes to the BD document shall be published at the latest 5 days before the submission deadline on the link provided below):

<https://millenniumkosovo.org/procurement/procurement-of-supply-installation-maintenance-of-relevant-equipment-and-services-for-the-introduction-of-consumption-based-heat-metering-and-thermostatic-heating-valves-in-district-heating-system-i>

Please fill in the form in the above-mentioned link in order to get further updates on this procurement.

Bidders interested in submitting a bid should register their interest by sending a completed registration, with the reference and subject of the ITB to the Procurement manager at procurement@millenniumkosovo.org, giving full contact details of the bidder.

Bids must be delivered Electronically only (One electronic copy) submitting your bid using this File Request Link: <https://www.dropbox.com/request/fMpYznuZl8E8guv0kaSj> on or before 22 April 2021; 14:00 pm (Kosovo Time) specified in BDS ITB 24.6. Late bids will be rejected. Bids will be publicly opened in the presence of the bidders' designated representatives and anyone who chooses to attend online via Zoom link: <https://us02web.zoom.us/j/83913870800> on 22 April 2021; 14:30 pm (Kosovo Time).

All bids will be accompanied by a Bid Security of EUR 85.000 as specified in BDS ITB 22.1 and 22.2 (a).

Contact Information:

The address referred to above is:	Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Attn:	Arton Çitaku, MFK Procurement Manager
Tel:	00 383 38 752 110
E-mail:	procurement@millenniumkosovo.org
Website:	https://millenniumkosovo.org



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine
Ministry of Economy and Environment

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë
për Kushtet Ndërtimore

"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Nr. prot: 507/21 të datës 05.02.2021, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomandë:
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Myrvete Fehmi Fazliu shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme SH.M.T. "Fan S. Noli" Podujevë.
- ▶ Edin Ibra shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Lidhja e Prizrenit" Prizren
- ▶ Zymryt Derdovski shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Lulzim Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Pjeter Budi" Lubizhd e Hasit.
- ▶ Faruk H. Shala B.I me emër tregtar N.T. "Proton" shpall të pavlefshëm certifikatën e regjistrimit të biznesit më numër UNIK identifikues: 810506834.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj lokalit me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

